



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor
Mbledhja nr. 63
Prishtinë, më 26.4.2017, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Adem Salihaj, Time Kadrijaj, Haxhi Shala, Sergjan Popoviq, Shaip Muja, Emilija Rexhepi dhe Murat Hoxha.

Mungoi: Salih Salihu.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 20.4.2017;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të ARRU -së për vitin 2016;
4. Të ndryshme.

Kryesuesja, **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen, sipas rendit të përcaktuar të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës, për këtë mbledhje, u miratua pa ndonjë shtesë.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 20.4.2017

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 20.4.2017, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të ARRU-së për vitin 2016

Kryetarja, Duda Balje, falënderoi për pjesëmarrje të mysafirëve nga autoriteti i ujërave dhe ftoi drejtorin **Raif Preteni** të marr fjalën. Ai falënderoi komisionin dhe raportoi në pika të shkurta, duke potencuar se prioritet në këtë autoritet ka qenë licencimi i kompanive prej 31 maj 2016 me afat deri 10 shtator 2018, kurse në vazhdim njoftoi komisionin edhe për 6 aktet e nxjerra nënligjore dhe për rregulloret e brendshme. Në favor të konsumatorëve, vazhdoi ai, ky autoritet gjatë vitit 2016 ka rishikuar tarifat, janë korrigjuar disa nga tarifat dytësore, si dhe është zbritur taksa administrative për lidhje dhe rilidhje ilegale, është zhvilluar inspektimi në të gjithë ofruesit e shërbimeve. Mesatarja e mbulueshmërisë me shërbime të ujësjellësit për 7 ofruesit e shërbimeve në 2016 është 90% dhe është 3% më e lartë se në vitin paraprak, mesatarja e mbulueshmërisë me shërbime të ujërave të ndotura për 7 ofruesit e shërbimeve në 2016 është 69% dhe është 4% më e lartë se në vitin paraprak, niveli i ujit të pa faturuar në mesatare të sektorit, në raport me ujin e prodhuar dhe distribuuar te konsumatorët, gjatë vitit 2016 shprehur në përqindje, është në nivelin 57%. Në krahasim me vitin 2015 ky tregues ka shënuar zhvillim negativ me rritje 1%. Shkalla e arkëtimit në nivel të sektorit për vitin 2016 është 86%. Në krahasim me vitin 2015 në nivel të sektorit, ky tregues ka shënuar zhvillim pozitiv me rritje 12 %.

Shaip Muja duke falënderuar për raportimin potencoi problemin e veriut në Mitrovicë p.sh. operimin nga “Vodovod Ibar” e cila kompani edhe në raport duhet të quhet ilegal, kurse **Adem Salihaj** u fokusua në problemin shumë prezent dhe brengosës të humbjeve të ujit duke potencuar se rrjedhja nga gypat asgjë nuk janë në krahasim me humbjet e mëdha siç janë ujitjet e ndryshme të pa-faturuara dhe që shkaktojnë dëme ekonomike d.m.th. nuk ka kontrollim të ujit, (një nga solucionet e mundura ai propozoi vënien e ujëmatësve jashtë oborrit në mënyrë që të shihet kush është keqpërdorues), përndryshe mosbalancimi i shifrës prej 81 milionë humbje me shifrën 61 milionë të faturuar duhet të na brengos të gjithëve, ndaj kërkoi që ARRU të propozoj ndryshimet që duhet bërë, në mënyrë që komisioni të intervenoi nëse ka nevojë edhe me ndryshime ligjore adekuate. Ferizaj p.sh. me letra i ka punët mirë me ujë, vazhdoi, ngase mjaftueshëm ka ujë, mirëpo nëse analizojmë pse ka reduktime vijmë deri te konstatimi i lartcekur të humbjeve të ujit në përmasa të mëdha. Edhe një herë potencoi se kompanitë duhet të obligohen për punë shumë serioze, duke shkarkuar bordet ose ngjashëm. **Murat Hoxha** pyeti për disa konstatime tabelore të pa harmonizuara ose të sqaruara jo mirë, po ashtu u interesua për rolin e shoqatës SHUKOS çfarë beneficione ka autoriteti duke bashkëpunuar me të,

sidomos u fokusua në çështjen e potencuar nga kjo shoqatë sa është alarmuese mos pagesa e ujit nga institucionet fetare.

Time Kadrijaj vlerësoi lartë kontributin e ARRU e cila në fund, siç konstatoi ajo, ka propozuar rekomandime për vete të cilat do të obligojnë atë, por në bashkërendim me komisionin-kuvendin.

Drejtori Raif Preteni filloi me përgjigje në pyetjen e z. Muja duke thënë se kanë të njohur veprimin ilegal të kompanisë në fjalë dhe mu për këtë edhe kanë parashtruar padi penale, gjithashtu potencoi edhe disa shembuj të tjerë që tregojnë veprimet ilegale në këtë pjesë të Kosovës, në këtë drejtim ARRU ka mbështetjen e zyrës Zvicerane duke bërë përpjekje për futjen në ombrellën e legjislacionit Kosovar këtë pjesë, por ata refuzojnë (për Shtërpcën, Artanën (Novo Bërdën) etj. tha se nuk ka probleme ligjore). Qeveria, vazhdoi ai, paguan borxhet e ujit për pjesën veriore, por nuk e kish idenë sa mund të vazhdojë kështu kjo gjendje. Rreth problemit që ka potencuar SHUKOS-i, drejtori, por edhe konstatim i përbashkët ishte se askund nuk ka rregull apo ligj që dikush lirohet nga pagesa e ujit, megjithëkëtë **Adem Salihaj** kërkoi të dihet sa harxhojnë këto institucione fetare, për çka zëvendësdrejtori **Xhelal Selmani** premtoi se së shpejti do të dihen rezultatet e auditivit se kush sa harxhon ujë në Kosovë. Reagoi prapë **Shaip Muja** sepse siç tha ai, uji është aset i Kosovës dhe duhet që ARRU direkt të komunikoi me Brukselin ngase kemi dështime të numerta te Ministrisë së Integrimeve d. m. th. ARRU të bashkëngjis opinionin e vet duke ja bashkëngjitur shkresave zyrtare për Bruksel. Drejtori, z. Preteni, u përgjigj se është i gatshëm në këtë mënyrë të veprojë nëse autorizohet nga ky komision, por **Adem Salihaj** ndërmjetësoi duke theksuar se kjo pjesë veriore e Kosovës nuk është se nuk paguan vetëm ujin, ajo nuk paguan edhe shumë gjëra të tjera dhe siç dihet ajo pjesë për Kosovën paraqet problemin kryesor politik që e ka ajo, prandaj kjo qeveri dhe tjerat duhet me ngulmë por shkallë -shkallë të përvetësojë këtë pjesë të Kosovës. Kryetarja e komisionit ftoi komisionin për të vendosur për raportin, ndaj nxori:

P Ë R F U N D I M

Miratohet raporti vjetor i ARRU-së për vitin 2016 dhe i rekomandohet mbledhjes plenare për miratim.

3. Shqyrtimi i projektligjit për kompleksin memorial “Adem Jashari” në Prekaz

Lidhur me këtë projektligj kryetarja **Duda Balje** ja dha fjalën kryesuesit të GP **Shaip Muja**, i cili njoftoi komisionin se ky projektligj është i gatshëm për leximin e dytë duke propozuar këto vërejtje:

Amendamenti 1

Në tërë tekstin e Projektligjit, “**Kompleksi Memorial “Adem Jashari”, “Kompleksi Memorial” dhe “kompleksi”**”: zëvendësohet me: “**Kompleksi Memorial “Adem Jashari” në Prekaz**”.

Amendamenti 2

Neni 2, paragrafi 1.9.

Pas fjalës “**rastin**” të shtohet edhe “**shënimit të**” dhe vazhdon teksti ashtu siç është.

Amendamenti 3

Neni 5, paragrafi 2, në fund fjala “**Agjencisë**” zëvendësohet me “**Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (në tekstin e mëtejshmë- Agjencia).**”

Paragrafi 3, shkurtesa: “**OVL të UÇK-së**” zëvendësohet me “**Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës**”

Amendamenti 4

Kapitulli “VI” zëvendësohet me “**Kapitulli V**”, dhe vazhdon numërimi.

Komisioni nxori:

P Ë R F U N D I M

Miratohen amendamentet e propozuara për projektligjin e kompleksit “Adem Jashari” në Prekaz të cilat procedohen më tutje në komisionet e përhershme.

4.Të ndryshme

Në pikën të ndryshme kryetarja ftoi komisionin që më 3 maj të prezantojnë në takimin me homologët Kroat dhe Hungarez i cili takim do të organizohet nga projekti i Binjakëzimit, ndërsa mbledhja e komisionit u caktua më 5 maj kur do të ftohet ministri i Bujqësisë për raportim financiar, por edhe për disa çështje të tjera, siç janë dëmet e shkaktuara në bujqësi, sidomos në bletari, deri në prill 2017.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti: Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Duda Balje